



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

FTESË PUBLIKE PËR PJESËMARRJE NË SHQYRTIM PUBLIK NË PROCESIN E PËRGATITJES SË PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË MITROVICËS SË JUGUT

Për: Qytetarët e Qytetit të Mitrovicës së Jugut, Personave Juridik,
Shoqatave dhe Grupet tjera

Lokacioni: Qendra e Kulturës “Rexhep Mitrovica “ në Mitrovicë

Data: 23.07.2020

Koha: 13:30

Të nderuar qytetarë të Qytetit të Mitrovicës së Jugut

Drejtoria e Planifikimit dhe Urbanizmit (DPU) në bashkëpunim me kompaninë "INSTI" nga Prishtina, ka kënaqësinë t'ju ftojë të jeni pjesë e Shqyrtimit Publik për draft Planin Zhvillimor Komunal të Mitrovicës së Jugut.

DPU kërkon pjesëmarrjen tuaj aktive dhe njoftimin tuaj mbi përpjekjet e Komunës për të përgatitur PZHK-në për Mitrovicën e Jugut, dhe gjatë këtij procesi në mirëpresim nga ju që të paraqitni propozimet, vërejtjet dhe sugjerimet për hartimin e këtij dokumenti shumë të rëndësishëm.

DPU është e përkushtuar të bashkëpunojë ngushtë me të gjitha palët e interesuara që janë të gatshme për të kontribuar për përgatitjen e një Plani Zhvillimor Komunal të qëndrueshëm për Komunën tonë dhe pronat tuaja, për 8(tetë) vitet e ardhshme 2020-2028.

Pjesëmarrja juaj do të mundësojë një planifikim të mirëfilltë duke ndikuar dhe kontribuar drejtpërsëdrejti në përmirësimin e jetës në vendbanimin tuaj.

Pjesëmarrësit e interesuar, janë të obliguar që, me rastin e ardhjes t'i respektojnë në mënyrë strikte masat e caktuara nga IKSHP dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, siç janë; të jenë të pajisur me maska mbrojtëse, si dhe t'a respektojnë mbajtjen e distancës së paraparë për siguri të secilit.

Me respekt.